



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.12.2019,
duke filluar në orën 13:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rrahmani, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Venera Morina, zyrtare e Drejtorisë së Pronës, Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Urbanizmit, Habib Qorri, përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Fatmir Bilalli, përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Isa Avdiu zyrtar nga Drejtoria e Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Osman Bllaca propozoi që të futen si pika të rendit të ditës dy propozime: "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit" dhe "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing "SHA, Prishtinë", në shumën prej 29,000.00 €, mjete të dedikuara vetëm për pagat e stafit.

Halim Halimi ishte i mendimit që këto pika të cilat u propozuan të mos futen në rend të ditës, pasi që nuk jemi të përgatitur këtu dhe kërkoi që njëherë e përgjithmonë të hiqet kjo politikë e keqe.

Agim Gashi tha se pajtohem me z. Halimi se shpesh po ndodhë që po na sillen materialet pa u shqyrtuar paraprakisht në komitetet përkatëse, në këtë rast Komiteti për pronë, ani pse nuk është komitet obligativ ai është një filtër, trup i Kuvendit që duhet të funksionoj për ti kaluar

Faqe 1 nga 9



çfarë do pa rregullsie të mundshme qoftë edhe teknike, pra asnjë pikë e rendit të ditës nuk kalon në procedura të trupave të Kuvendit, përpos KPF-së.

Sa i përket ndërmarrjes "Sport Marketing" ne e dimë se si funksion kjo ndërmarrje, nga i ka burimet, sa ka kapacitete grumbulluese materiale. Ajo ndërmarrje varet prej kushteve atmosferike verës dhe dimrit, e kjo është e rëndësishme për ne se ka një rol funksional në fushën e edukimit sportivë qoftë në shkollën e notit, qoftë në shkollën e skijimit dhe ka mundësi të zgjerohen kapacitetet rreth ndërmarrjes se Komuna e ka atë mundësi me investuar. **Osman Bllaca** tha se sa i përket dërgimit të materialit ne e dimë që duhet 7 ditë me dërguara para mbledhjes por kjo nuk varet prej neve si Komunë, varet prej ndërmarrjeve e tash kërkesa e ndërmarrjes ka ardhur me vonesë.

Eman Rahmani tha se shqetësuese për mua është fakti që jemi prapë këtu te një pikë ku duhet me ndarë mjete për ndërmarrjen 'Sport Marketing'. Dihet që edhe vitin e kaluar kemi ndarë mbi 100 mijë euro kësaj ndërmarrje dhe vërejtjet tona kanë qenë që prapë këtë vit kemi me nda se nuk ka asnjë plan biznesi, as një plan zhvillimor që ka mi siguruar të hyra kësaj ndërmarrje. Kësaj ndërmarrje ju ka marr objekti në Brezovicë, nuk është në pronë të "Sport Marketingut" dhe Prishtina nuk e ka në shfrytëzim.

Po ashtu propozoi që si pikë të rendit të ditës për Kuvend të hynë edhe diskutim mbi procesin, se çka ka ndodhë në "Prishtina Parking" gjatë këtyre dy viteve dhe pse nuk është formuar.

Osman Bllaca tha se për të hy në rend të ditës kjo pikë, duhet mu bërë një Raport komunal i aksionarëve të kësaj ndërmarrje.

Sami Boroci tha se jemi pro propozimit që këto dy pika të hyjnë për diskutim në rend të ditës. Sa i përket "Sport Marketing" vitin e kaluar ju kam drejtuar me shkresë ekzekutivit dhe i kam kërkuar që me pa mundësinë që kësaj ndërmarrje me ja zgjeruar kompetencat se kjo funksionon vetëm me një operator vetëm me "Pishinën e Gërmisë" dhe e ka jashtë shfrytëzimit të vet "Shtëpinë e Gurit". Po ashtu kamë kërkuar me pa mundësinë që hapësirat reklamuese, terrenet sportive edhe një pjesë ndoshta edhe të sallës "1 Tetori" me ja dhënë në shfrytëzim "Sport Marketingut", në mënyrë që të bëhet e vetë qëndrueshme ndërmarrja.

Egzon Azemi tha se sa i përket çështjes së "Sport Marketingut" kësaj ndërmarrje ose duhet me ja ndërrua emrin ose me lënë ndërmarrja "Pishina e Gërmisë" ose me ja rrit kompetencat se vet emri "Sport Marketing" tregon se kjo ndërmarrje është dashtë me menaxhuar sportin dhe marketingun në kryeqytet.

Do të ishte mirë që ta votojmë këtë propozim, me kushtin që paraprakisht e votojmë një ri plotësim të kësaj ndërmarrje, ja rrisim kompetencat si Kuvend Komunal sepse e kemi këtë të drejtë.

Kryesuesi tha se fuqishëm e mbështes çdo ide se si këtyre ndërmarrjeve me ju shtuar asetet,

në mënyrë që ato me mbajtë veten ato që janë, andaj do të ishte mirë që këtë propozimvendim me e miratuar.

Sami Boroci kërkoi një shpjegim nga Zyra ligjore, se qysh është procedura me i zgjeruar kompetencat e kësaj ndërmarrje.

Lidhur me çështjen e ngritura nga z. Boroci, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore dha sqarime të nevojshme.

Osman Bllaca dha se në bazë të ligjit, ne kemi mundësi me bërë delegim të kompetencave në këtë rast është delegimi i kompetencave prej Komunës në nivel ndërmarrje.

Fadil Gashi tha se në mbledhjen e kaluar morën vendim që gjithë drejtorët me qenë këtu, asnë drejtor nuk është këtu përvèç drejtoreshës së Drejtorisë së Financave,asnë nuk vjen dhe askujt nuk i japin përgjegjësi, dhe do të ishte ma mirë që ata me qenë këtu dhe me na sqarua gjërat.

Eman Rahmani kërkoi që në seancën e radhës të na sillet një informacion se, kujt i është dhënë hapësira për patinazh te sheshi "Zahir Pajaziti" dhe pse nuk ju ka dhënë "Sport Marketingut" që kishte mundur të krijojë do të hyra. Po ashtu kam kërkuar që të gjitha ndërmarrjet publike të kenë auditim të performancës, por nuk kemi gjetur mbështetje dhe tani kërkojmë bashkarisht që të ketë auditim të performancës për "Sport- Marketingun", ku do të bëhej një analizë shumë e mirë e kësaj ndërmarrje, për me e ditur gjendjen e sakët ku është dhe kah mundet me shkua.

Leutrim Retkoceri tha se kishte qenë mirë me pas materialin dhe temë kryesore me qenë tatimi në pronë që ka me ardhur si propozim dhe është shumë me rëndësi për qytetarë sa ka me qenë ai tatim. Po ashtu propozoi që të jetë si pikë e rendit të ditës, ku do të propozohet ose iniciohet nga Kuvendi Komunal që të filloj formimi i Odës të Mjekëve të Prishtinës.

Egzon Azemi propozoj që për mbledhjen e radhës të Kuvendit si pikë e rendit të ditës të hynë edhe "Ndalesa për shitjen dhe përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë këtij viti", kur e dimë që ndotja e ajrit është në nivelin maksimal.

Fatos Dibra tha se për këtë vit ekzekutivi ka nxjerrë një urdhëresë për ndalimin e tyre.

Kryesuesi e holli në votim, që të futet si pikë në rendin e ditës: "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit.

Kryesuesi konstatai se, me 6 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, kjo pike hynë në rend dite si pikë e nëntë.

Kryesuesi e hodhi në votim që të futet si pikë në rendin e ditës "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing "SHA, Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se, me 5 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenim, kjo pikë hynë në rend dite si pikë e dhjetë.

Kryesuesi e hodhi në votim komplet rendin e ditës, me pikat që u shtuan.

Kryesuesi konstatoi se, me 5 vota për dhe 4 abstenime u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitet për Politikë dhe Financa;
2. Informatë mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës;
3. Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale ,01.nr.110-2782,dt.02.12.2011;
5. Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";
6. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020;
7. Propozimvendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve;
8. Propozimvendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit;
10. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing" SHA, Prishtinë;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitet për Politikë dhe Financa

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Informatë mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës

Agim Gashi tha se informata që na ka ardhur në përbajtje nuk është informatë, sepse nuk kanë arritur me trajtuar në mënyrë profesionale temën për të cilën ne e kemi ngrit, vetëm kanë

dhënë disa statistika të mangëta dhe të disa intervenimeve që i kanë bërë. Janë bërë disa intervenime nga njësia e zjarrfikësve, pra nuk janë trajtuar tema në kuptimin se çfarë nënkuftojmë me emergjencat, cilat janë kompetencat komunale në fushën e emergjencës, sa ka kapacitete të organizuara të menaxhueshme nga Komuna e Prishtinës në fushën e emergjencës dhe çështje tjera që dalin nga ligjet që rregullojnë fushat e emergjencës, ku të gjitha këto të dhëna mungojnë në pasqyrimin ose në të ashtuquajturën informatë.

Egzon Azemi tha se pajtohem me z. Gashi se ky raport është gjysmak të paktën ndër informatat elementare që është dashtë mu cek janë edhe strehimoret që janë të Komunës së Prishtinës, pra mu cek në çfarë gjendje janë ato, ai i plotësojnë kushtet, a ofrojnë kushte minimale që të janë të përdorshme për ndonjë rast etj. Kapacitetet e komunës tonë janë jashtëzakonisht të ulëta dhe duhet ta dimë saktë pasqyrën se cilat janë kapacitetet, cilat janë mundësítë e Komunës dhe të kemi një debat se çka mund të bëjmë më tutje që ti rrissim sado pak ato kapacitete.

Genc Sherifi tha se pajtohem me parafolësit se është mirë rapporti me qenë më i plotë që mos me na ndodhë ndonjë fatkeqësi e ne mos me qenë të përgatitur. Si kryeqytet që jemi e dimë se kemi ndërtimë të dobëta, dhe duhet ditur se si është gjendjen e strehimoreve edhe pse kam informata se strehimoret janë të pajisura mirë.

Agim Gashi tha se në diskutim e sipër nga parafolësit, u ngritën çështjet për mekanizmat që aktivizohen në rast të ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Ne kemi nevojë me ditë cila është gjendja aktuale në Komunën e Prishtinës në fushën e ndërtimit, te mos dhënia e lejeve të objekteve për përdorim, gjendja statike e objekteve shkolllore, objekteve tjera publike që na absorbojnë shumë njerëz brenda ditës, dëmet që mund të vijnë nga të reshurat atmosferike si pasoj e dëmtimit të pyjeve dhe çështje tjera që në situata të caktuara krijojnë situatë emergjente.

Kryesuesi tha se mbetet që deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit të plotësohet informata me të dhënat e cekura nga diskutuesit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informatë mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës

Pika e tretë

Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme

Lidhur me Propozimvendimin për tatimin në pronën e paluajtshme, në pikë të shkurtra të pranishmit i informoi **Venera Morina**, zyrtare e lartë në Drejtoria e Pronës.

Agim Gashi kërkoi informata sqaruese lidhur me kalimin në kompetencë të Qeverisë të tatimit në pronë.

Valbona Makolli - Ahmeti tha se para se të sillet ky propozim dhe ky vlerësim në Ministrin e Financave, tatimin në pronë ne e kemi kundërshtua si komunë në masë të madhe, por që nuk është marrë parasysh. I kemi paraqit vërejtjet tona edhe me ligj edhe me punën që e kemi bërë, mirëpo nuk është marrë parasysh, nuk jemi pajtuare dhe prapë nuk pajtohem i Ministrisë.

Egzon Azemi tha se këtu po cekët se në lagjet periferike është ulë tatimi në pronë, mirëpo në lagjet periferike tash në këtë rast janë lagjet luksoze si: "Qarshia", "Marigona" etj, është problem se zona industriale me qenë më e ulët se qendra, është dashur me qenë njëjtë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, Venera Morina dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.110-2782, dt.02.12.2011;

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.110-2782, dt.02.12.2011, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Venera Morina, zyrtare e lartë në Drejtorinë e Pronës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.110-2782, dt.02.12.2011 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit"

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizmit tha se ky plan ka ardhur si projekt draft për lënien në diskutim publike e pastaj nëse ka vërejtje, sugjerime do të shqyrtohen.

Egzon Azemi tha se për këtë plan nga qytetarët kemi ankesa jashtëzakonisht të mëdha, sepse është hapësira e vetme që e kanë dhe e shfrytëzojnë si park dhe janë kundër ndërtimit të objektit në at vend.

Agim Gashi pyeti se, në ndërhyrjet në Planet rregullative pa Hartë zonale a po krijohen probleme me Ligjin për planifikimin hapësinor.

Burbuqe Hydaverdi tha se sipas interpretimit të Ministrisë me Ligj të planifikimit është neni në të cilin thuhet që, nëse hartohen Plane rregullative të hollësishme ekziston neni që ato të inkorporohen gjatë hartimit të Planeve të hollësishme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Habib Qorri, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Fadil Gashi shtoi pyetjen se sa janë tarifat në parkingjet te banesat që shfrytëzohen për 24 orë. **Habib Qorri** dha se biletat mujore dhe vjetore janë paraparë për banorë si bileta e parkimit të privilegjuara që janë për banorë në zonën e parë 10,00 €, në zonën e dytë 7,00 € dhe zonën e tretë 5,00 €.

Agim Gashi tha se banorët rezident sidomos në lagjet ku është ndërtimi i lartë, mendoj se problemet do të jenë më të theksuara. Mendoj se kostoja prej 100,00 € është pak e lartë sado që neve na duket e vogël ajo e ngarkon atë shportën familjare, andaj ulja e shton sasinë e pagesës, sepse është e përballueshme, por edhe te çmimi 1 orë 1,00 €, mendoj se është i lartë.

Qëllimi im është që, vlera prej 100,00 € me zbrit në 80,00 € dhe 1,00 € me zbrit në 0.80 centë.

Fadil Gashi tha se sa i përket tarifës, janë çmime reale se shuma prej 10,00 € për një person për 1 veturë për 1 muaj në zonën e parë nuk është e lartë.

Eman Rahmani tha se çmimorja e kësaj rregullore është relativisht e mirë, por ka mundësi mu përmirësuar te zona e parë koha, të premteve dhe të shtunave mendoj që duhet mu zgjat koha mu bërë deri në ora 24:00 në zonën e parë. Te biletat e privileguara mendoj që për personat juridik dhe për punëtorët duhet mu bërë disa ndryshime. Te personat juridik mendoj që vlera është shumë e ulët në zonën e parë 45,00 € bleta për mujore. Kishte qenë mirë që në zonën e parë 60,00 € në zonën e dytë 45,00 € dhe në zonën e tretë 30,00 €, ndërsa te kategoria e punëtorëve mendoj duhet me u hjakë krejt dhe mos me pas mundësi ata me pas bleta të privileguara.

Sami Boroci kërkoi të dijë se si do të menaxhohen vend parkingjet ilegale - private.

Leutrim Retkoceri parashtroi pyetjen që, përveç çmimeve që janë, çka kanë me ju ofruar, çfarë kushte ju ofrohen përveç hapësirës, a do ti kenë edhe shenjat ku kanë me u parkuar, distancën etj.

Eman Rahmani tha se janë disa shqetësimet si te "Pallati i Rinisë" besoj se ka edhe të tjerë të cilëve ju ka shkuar një njoftim që prej datës 1 janar parkingjet duhet me i liruar, dhe çka do të bëhet me ata punëtorë që kanë punuar më se 10 vjet aty.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Habib Qorri, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, Prishtinë

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

Procesmbajtësja
Shyharete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta



A handwritten signature in blue ink is placed over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'PRISHTINA' around the perimeter and 'KOMUNA' in the center.

Faqe 9 nga 9

